



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost / Kosovo Academy for Public Safety

KËSHILLI I ETIKËS

RAPORT I AKTIVITETIT TË KËSHILLIT TË ETIKËS

I. TË DHËNAT BAZË

Titulli i aktivitetit:	Realizimi i aktivitetit për hartimin e materialeve promovuese dhe ndërgjegjësuere për etikën dhe integritetin akademik
Data:	26.06.2026
Vendi:	Salla e takimeve, nr. 24 Objekti i Drejtorisë së Përgjithshme të AKSP-së
Lloji i aktivitetit	<i>Takimi VI -të</i>

II. PJESËMARRËSIT

1. z. Florentina Shala – Braha- Kryesuese
2. z. Fitim Osmani – anëtar dhe
3. z. Faton Sahiti - anëtar

Të ftuar tjerë:

- Nuk ka

III. PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT

Më 26.06.2026, në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, u mbajt mbledhja e gjashtë e Këshillit të Etikës, ku u miratua procesverbali i mbledhjes nr. 05/2026, ndërsa fokusi kryesor ishte prezantimi i aktivitetit të realizuar për hartimin e materialeve promovuese dhe ndërgjegjësuere në fushën e etikës dhe integritetit akademik, konkretisht fletëpalosjes së Këshillit të Etikës.

U njoftua se, për realizimin e këtij aktiviteti, anëtarët e Këshillit të Etikës kanë zhvilluar edhe dy takime pune, gjatë të cilave janë diskutuar përmbajtja, struktura dhe dizajni i fletëpalosjes. Gjatë këtij procesi janë shqyrtuar propozime të ndryshme dhe është harmonizuar përmbajtja e saj me Manualin për Etikë dhe Integritet Akademik, me qëllim që materiali të jetë praktik, informues dhe i përshtatshëm për promovimin e kulturës së integritetit akademik te studentët, stafi akademik dhe personeli administrativ.

Në fund të diskutimeve, Këshilli i Etikës konstatoi se aktiviteti i planifikuar për hartimin e materialeve promovuese dhe ndërgjegjësuere është realizuar në përputhje me Planin e Punës dhe se fletëpalosja do të shërbejë si material informues në aktivitetet promovuese të Fakultetit për Siguri Publike.

Këshilli i Etikës ka diskutuar në takimin mënyrën dhe formën e prezantimit të këtij aktiviteti. Takimi u finalizua me zotimin e anëtarëve për bashkëpunim të ngushtë dhe përkushtim në përmbushjen e aktiviteteve të parapara në Planin Vjetor të aktiviteteve.

REZULTATET / VENDIMET KRYESORE

- Finalizimi i përmbajtjes dhe dizajni i fletëpalosjes në përputhje me Manualin për Etikë dhe Integritet Akademik.
- Fletëpalosja do të shërbejë si material informues në aktivitetet promovuese të Fakultetit për Siguri Publike.



AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE

ETIKA DHE INTEGRITETI AKADEMIK

Vlera që ndërtojnë besimin, profesionalizmin dhe përsosmërinë akademike.

Fakulteti i Sigurisë Publike

1. ÇFARË ËSHTË INTEGRITETI AKADEMIK?

Integriteti akademik përbën një nga shtyllat themelore të funksionimit që garanton ndershmërinë, besueshmërinë dhe cilësinë në procesin mësimor dhe kërkimor.

- NDERSHMËRIA**
Angazhimi etik për të vepruar me integritet, besueshmëri dhe përgjegjësi gjatë procesit të mësimit dhe kërkimit shkencor.
- PËRGJEGJËSIA**
Çdo anëtar i institucionit është përgjegjës për veprimet dhe vendimet e tij, si dhe për respektimin e standardeve etike dhe profesionale.
- DREJTËSIA**
Institucioni garanton trajtim të barabartë për të gjithë, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, në përputhje me legjislacionin dhe standardet e të drejtave të njeriut.
- RESPEKTI**
Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik duhet të trajtojnë njëri-tjetrin me nder, respekt dhe mirëkuptim, duke promovuar kulturë bashkëpunimi dhe komunikimi profesional.
- TRANSPARENCA**
Procesi akademik, administrativ dhe kërkimor duhet të zhvillohen në mënyrë të hapur, të qartë dhe të dokumentuar, duke garantuar besueshmëri dhe llogaridhënie institucionale.

2. ÇFARË PRITET NGA STUDENTËT?

Studentët janë përgjegjës për respektimin e parimeve të integritetit akademik në të gjitha aktivitetet e tyre mësimore dhe kërkimore.

- Kryeri punën tuaj në mënyrë të pavarur dhe të ndershme.
- Citoni saktë burimet që përdorni.
- Respektoni rregullat e provimeve dhe vlerësimit.
- Respektoni stafin akademik dhe kolegët.
- Raportoni sjelljet që cenojnë etikën akademike.

3. SHKELQET E INTEGRITETIT AKADEMIK

Shkeljet e integritetit akademik konsiderohen çdo veprim që cenon parimet e ndershmërisë dhe korrektesisë në aktivitetet akademike.

- PLAGJIATURA**
Paraqitja e dësht e punës së një personi tjetër si të vetat, pa citimin dhe referimin e duhur të burimit.
- KOPJIMI**
Kopjimi i gjerë provimeve ose punimeve.
- MASHTRIMI AKADEMIK**
Çdo veprim i qëllimshëm për të siguruar përfundim ose avantazh të padrejtë në hulumtim, publikim apo aktivitet të tjera akademike.
- FALSIFIKIMI I TË DHËNAVE**
Ndryshimi, trimimi ose paraqitja e meje e të dhënave.

Shkeljet e etikës akademike kanë pasojë institucionale.

4. ETIKA NË HULUMTIM

Përfaqëson tërësinë e parimeve dhe standardeve që udhëheqin zhvillimin e aktiviteteve kërkimore në duke garantuar integritet, besueshmëri dhe përgjegjësi.

- SINERITETI SHKENCOR**
Raportojmë të vërtetën shkencore, pa shtrembërime.
- OBJEKTIVITETI**
Jemi të paanshëm dhe bazohemi në fakte.
- KONFIDENCIALITETI**
Ruajmë informatat dhe të dhënat e pjesëmarrësve.
- STANDARDET ETIKE**
Respektojmë udhëzimet dhe standardet etike në hulumtim.

5. NË ZHVILLIMIN KULTURËN E INTEGRITETIT

Edukimi dhe promovimi i etikës dhe integritetit akademik përbëjnë një element të rëndësishëm për ndërtimin e një kulture institucionale të bazuar në ndershmëri, transparencë dhe përgjegjësi.

- Përmes edukimit dhe trajnimeve të vazhdueshme.
- Përmes dialogut dhe diskutimit të hapur.
- Përmes shembullit të mirë dhe udhëheqjes etike.
- Përmes zbatimit të rregullave dhe përgjegjësisë institucionale.

Së bashku ndërtojmë një mjedis akademik të ndershëm, të besueshëm dhe profesional!

NJË AKADEMI, NJË MISION, NJË VLERË

PROFESIONALIZËM INTEGRITET PËRGJEGJËSI

Këshilli i Etikës:
Organi përgjegjës për promovimin, mbikëqyrjen, edukimin dhe trajtimin e çështjeve/shkeljeve të etikës.

Adresa: Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Rruga Gjergj Kastrioti Skënderbeu nr. 60
42000 Vushtri
Republika e Kosovës

Tel: +383 (0)28 59 00 70, lok. 119
E-mail: zip.aksp@rks-gov.net
http://www.aksp-ks.net/

Kontakt: Facebook, Instagram, YouTube
Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Akademia për Siguri Publike

KOSOVO ACADEMY FOR PUBLIC SAFETY